



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.05.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kerkesës për rishqyrtim të datës 10.05.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Urban Plus" për aktivitetin :"**Transporti i nxenesve dhe arsimtareve**" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-1046-221 nxjerr:

V E N D I M

1. Aprovohet pjesërisht kërkesa e Operatorit Ekonomik "Minibus Agron Osmani" e datës 10.05.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "**Transporti i nxenesve dhe arsimtareve**", me Nr.616 19 1046 221, kundër Njoftimit për Vendimin e AK-së ,të dates 06.05.2019,te publikuar ne E Prokurim;
2. Vërtetohet Vendimi për i Ak-se per linjat 1,2 dhe 2 i publikuar me datë: 08.05.2019,ndersa që te pezulloj aktivitetin dhe per linjen 4 te kthehet ne rivleresim.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Minibus Agron Osmani" me datë 10.05.2019 ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: :"**Transporti i nxenesve dhe arsimtareve**".

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.05.2019, ka shqyrtuar ankesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon lidhur me pretendimet ankimore të tenderuesit:

-Tenderuesi në bazë të njoftimit për Vendimin e AK-së ka shprehur mospajtimin e tij lidhur me propozimin për dhenje të kontratës për relacionin 4 në të cilën është propozuar OE-ik "Auto Taxi Bujar Stublla". Në pretendimin e tij ankuesi ka kontestuar automjetin e të propozuarit dhe lejen e vozitjes (kategorinë e saj).

Autoriteti kontraktues konstaton këto dy pretendime si të bazuara dhe vendos që aktiviteti për këtë linjë të kthehet në rivleresim.

Pretendimi tjetër lidhur me mungesën e ofertave për lotin 2 nuk qëndron pasi që komisioni i vlerësimit ka konstatuar se OE-ik "Minibus Xhavit Osmani" ka dorëzuar tender për linjen 2 dhe 3 e jo siç është paraqitur në hapjen e tendereve për lotet 1 dhe 3.

Bazuar në faktin se Autoriteti Kontraktues ka konstatuar si të bazuara vetëm pretendimet që kanë të bëjnë me linjen 4, vendos që e njëjta të kthehet në rivlerësim, ndërsa të vazhdoj aktivitetin për linjat tjera sipas Njoftimit për Vendimin e AK-së të datës 06.05.2019.

Nga konstatimet paraqitura u vendos si në Dispozitiv të Vendimit.

Verejtje: Pala e përkrahur me këtë Vendim mund të paraqesë ankesë në OSHP në afat prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit